

GJON BORIÇI

Instituti i Historisë/ Akademia e Shkencave e Shqipërisë
gjon.borici@asa.edu.al

**NJË VËSHTRIM NË TERMA POLITIKO-EKONOMIKË
NDËRMJET SHQIPËRISË DHE JUGOSLLAVISË NË
PERIUDHËN 1945-1949**

(Pjesa e parë, janar 1945 - qershor 1947)

Abstrakt:

Problematikat politiko-ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë kanë tërhequr vëmendjen gjatë dy dekadave të fundit në qarqet studimore akademike në Shqipëri. Duke qenë se Jugosllavia ishte partneri i parë i rëndësishëm i Shqipërisë së pasçlirimit deri në gjysmën e parë të vitit 1948, shumë prej problemeve të marrëdhënies së ngushtë dhe jetëshkurtër që patën të dyja vendet, për mendimin tim, nuk janë trajtuar gjerësisht, aq më tepër në sfondin ekonomik të ndikimit të madh që ushtroi politika jugosllave mbi vendin tonë. Në muajt e fundit të Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria ashtu sikurse edhe Jugosllavia ishin çliruar në vjeshtën e vitit 1944, gjatë muaj përpara përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Duke qenë se lidhshipi i ri jugosllav kishte "sponsorizuar" jo pak politikisht në krijimin e Partisë Komuniste Shqiptare dhe madje kishte menaxhuar të gjithë situatën politike të forcës kryesore në pushtetin e ri, nëpërmjet mekanizmave të tërë ekonomike, arriti brenda dy vjetësh të kishte kontrollin e plotë ekonomiko-politik mbi Shqipërinë. Sistemi politik jugosllav nuk ndryshonte në fillimet e veta nga modeli sovjetik, por udhëheqësi i atij vendi Josip Broz Tito kishte "mendjen" e tij për sa i përkiste rrugës që do të ndiqte Jugosllavia në realitetin e ri të marrëdhënieve ndërkombëtare që po kristalizohej. Enver Hoxhës i interesonte mbrojtja e një vendi më të fuqishëm se Shqipëria që të mbijetonte politikisht, paçka se ekonomikisht do të ishte gjithnjë i varur nga kreditë dhe ndihmat që do t'i jepeshin. Titos i interesonte pavarësia politike e rrjedhimisht ekonomike për të qenë një zë i rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare në fillimet e Luftës së Ftohtë. Artikulli që po paraqesim është i mbështetur në metodologjinë analitiko-krahasuese, gërshetuar me dokumentacion arkivor dhe literaturë kombëtare e ndërkombëtare për të sjellë në vëmendjen e

studiuesve dhe jo vetëm, dallimet thelbësore në mënyrën se si u menaxhua pushteti në këto dy vende.

Fjalë kyçe:

Shqipëri, Jugosllavi, Enver Hoxha, Tito, politikë, ekonomi, varësi.

Hyrje

Marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë në periudhën 1945-1948 ishin tepër intensive duke sjellë varësi të plotë politiko-ekonomike të së parës ndaj së dytës. Është i njohur fakti se, sa më i thellë të jetë integrimi ekonomik ndërmjet dy vendeve aq më shumë mundësi kanë për të qenë konkurrese në tregjet përkatëse dhe në ato rajonale e ndërkombëtare.¹ Logjika që ndoqi Jugosllavia nën drejtimin e Josip Broz Titos në marrëdhëniet e saj me Shqipërinë, ishte bazuar në terma thjesht varësie ekonomike për të mbajtur të nënshtruar fqinjin e vogël ballkanik. Nga hulumtimi i kujdesshëm i materialeve arkivore ku disa prej të cilave po i paraqes për herë të parë, bie në sy fakti se që në gjysmën e parë të vitit 1945 edhe pse kishte pësuar shkatërrime të mëdha nga lufta, përsëri monedha shqiptare [franga] ishte disa herë më e fuqishme sesa dinari i ri jugosllav. Megjithatë, duke përfituar nga gabimet foshnjarake të lidërsipit të papërvojë komunist shqiptar, shteti jugosllav nën drejtimin e Titos ia doli mbanë që brenda një viti e gjysmë nga fillimi i marrëdhënies së ngushtë ndërmjet dy vendeve të bënte që monedha shqiptare të barazohej me dinarin jugosllav dhe jo vetëm aq, por një sasi e madhe e arit shqiptar të kalonte në Jugosllavi. Duke varfëruar monedhën shqiptare, Jugosllavia nën drejtimin e Titos ia doli mbanë që Shqipëria t'i falej tërësisht ekonomikisht e rrjedhimisht politikisht Jugosllavisë deri në pranimin pa kushte të planit jugosllav për bashkim të të dyja vendeve në një konfederatë ballkanike. Në këtë pjesë të parë të këtij artikulli, hipoteza kryesore që kam shtruar është: ku gaboi politikisht Shqipëria për t'i dhënë Jugosllavisë një mundësi të papërsëritshme në asgjësimin e pavarësisë së shtetit shqiptar? Çfarë e detyroi aq hapur Kryeministrin shqiptar Enver Hoxha të pranonte në dy vjet e gjysmë të

¹ Vladimir Unkovski-Korica, *The economic struggle for power in Tito's Yugoslavia; from World War II to Non-Alignment* (London: I.B. Tauris, 2016), 3.

fillimit të pushtetit të tij çdo gjë nga Jugosllavia, qofshin këto edhe në dëm të interesave kombëtarë? Sa ndikoi në marrëdhënien e varësisë që u krijua pesha specifike e Shqipërisë dhe e Jugosllavisë në marrëdhëniet me Fuqitë e tjera të Mëdha fituese të Luftës së Dytë Botërore? Shqipërisë, rruga e varësisë ndaj Jugosllavisë në periudhën nga viti 1945 deri në gjysmën e parë të vitit 1948 iu imponua apo e pranoi me dëshirë? Të gjitha këtyre pyetjeve dhe hipotezave do të përpiqem t'iu jap përgjigje në vijim të këtij artikulli.

Gabimet ekonomike të Shqipërisë së pasluftës, 1945

Pas çlirimit, shqetësimi parësor për qeverinë e re shqiptare ishte marrja e sa më shumë ndihmave nga vendet perëndimore dhe më mirë se UNRRA* askush nuk mund ta bënte këtë. Kështu, që më datë 26 shkurt 1945, Enver Hoxha në cilësinë e kryeministrit i dërgoi një letër Komisionit Qendror të UNRRA-s ku shprehu besimin se popullit shqiptar, si aleat i Kombeve të Bashkuara si në luftë dhe në paqe, nuk do t'i kursehej asnjë ndihmë pasi kishte nevojë urgjente për ushqime, veshmbathje, materiale sanitare, mjete ndërtimi e komunikacioni si dhe çdo send tjetër që i nevojitej për të ngritur ekonominë e vendit dhe për të ndërtuar "vendin tonë të djegur".² Për këtë arsye, më 1 gusht 1945 u nënshkrua marrëveshja e parë ndërmjet qeverisë demokratike të Shqipërisë dhe UNRRA-s për dërgimin në Shqipëri të ndihmave për të rimëkëmbur vendin e shkatërruar nga lufta.³ Marrëveshja e parë me UNRRA-n ishte pa dyshim një ndihmë e madhe, por sigurisht që nuk i përmbushte të gjitha pritshmëritë ekonomike të Shqipërisë. Viti 1945 ishte një vit tej mase i vështirë ekonomikisht për vendin. Shqipëria kishte nevojë të ngutshme të gjente të ardhura për të plotësuar nevojat më jetike të vendit. Përpara firmosjes së marrëveshjes me UNRRA-n, qeveria shqiptare pa mbaruar ende lufta në Europë dhe saktësisht më 12 prill 1945, Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë i dërgoi një

* UNRRA - United Nations Relief and Rehabilitation Administration.

² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) F. 490/ Këshilli i Ministrave (KM), Viti (më tej: V.) 1945, Dosja (më tej: D.) 107, fl. 23-24. Letra e plotë e Enver Hoxhës dërguar Komisionit Qendror të UNRRA-s.

³ *Po aty*, F. 490/KM, V. 1945, D. 21, fl. 11-20. Marrëveshje të lidhura midis qeverisë demokratike shqiptare dhe administratës së UNRRA-s mbi furnizimet dhe shërbimet e UNRRA-s në Shqipëri; shih edhe Hamit Kaba, *UNRRA në Shqipëri, 1944-1947* (Tiranë: Shkenca, 2000), 122.

promemorie Kryeministrisë lidhur me depozitën e arit të ish-Bankës Kombëtare të Shqipërisë që ishte tërhequr prej autoriteteve gjermane pas kapitullimit të Italisë.⁴ Nga ky dokument, vërejmë se, depozita e arit të ish-Bankës Kombëtare ndodhej në Romë dhe ishte tërhequr prej autoriteteve gjermane dhe ishte dërguar në Berlin e depozituar në Reichsbank.⁵ Nga Ministria e Punëve të Jashtme rekomandohej se ishte oportune që të viheshin në dijeni Fuqitë Aleate, paçka se lufta ende nuk kishte përfunduar pasi ende lufohej në dyert e Berlinit.⁶ Lidhur me këtë çështje jetike për Shqipërinë në vitin 1945, profesor Ksenofon Krisafi i ka kushtuar një studim të rëndësishëm. Sipas prof. Krisafit, sasia e arit e transferuar në Gjermani nga selia e Bankës së Romës dhe e Bankës së Italisë më 16 shtator 1943 ishte 2 338 7565 kg ar shqiptar.⁷ Po ashtu, bashkë me rezervën e arit shqiptar prej 8 062 826,90 franga ari në atë kohë, në Romë u mor rezerva e kartmonedhave me peshë rreth 12 ton, në shumën 120 523 902 franga shqiptare, si dhe të gjitha klisjetë e stampimit të kartmonedhave.⁸ Mungesa e rezervave të arit dhe, siç do ta shohim më poshtë, gabimet tragjike ekonomike duke goditur biznesin e ri shqiptar, do të ishin faktorët e parë të nënshtrimit ekonomik të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë.

Më datë 12 janar 1945, Kryeministri Hoxha i dërgoi për "aprovim" Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar kopjen e vendimit të Këshillit të Ministrave të datës 11 janar 1945 me projektligjet përkatëse, ku më i rëndi ishte ai mbi tatimin e jashtëzakonshëm të fitimeve të luftës.⁹ Për të treguar se ishte i vëmendshëm ndaj "propozimeve" që vinin nga dikasteret e tjera, Enver Hoxha në fakt kishte miratuar propozimin e ardhur nga Ministria e Financave mbi tatimin e jashtëzakonshëm të nënshkruar nga ministri Ramadan Çitaku më datë 5 janar 1945.¹⁰

⁴ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1945, D. 22, fl. 1. Korrespondencë e Këshillit të Ministrave me Ministrinë e Jashtme, mbi përcjelljen e një promemorieje mbi depozitën e arit të ish-Bankës Kombëtare të Shqipërisë që është tërhequr prej autoriteteve gjermane mbas kapitullimit të Italisë.

⁵ *Po aty*, fl. 2.

⁶ *Po aty*.

⁷ Ksenofon Krisafi, *Në kërkim të arit. Historia e arit shqiptar të rrëmbyer gjatë Luftës së Dytë Botërore* (Tiranë: Dita 2000 & UET Press, 2008), 33.

⁸ *Po aty*, 34.

⁹ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1945, D. 74, fl. 2. Tatime të jashtëzakonshme dhe konfiskime pasurish. Vendimi i qeverisë i datës 11 janar 1945.

¹⁰ *Po aty*, fl. 3.

Më 26 prill 1945, qeveria shqiptare vendosi për t'i paraqitur për miratim Këshillit të Lartë Antifashist Nacionalçlirimtar i cili kryente funksionet e organit më të lartë ligjvënës meqë në Shqipëri ende nuk ishin mbajtur zgjedhje parlamentare, tetë projektligje ku më të rëndët ishin pikat 5 dhe 6 në të cilat abrogoheshin rrogat jetike dhe taksoheshin pijet alkoolike.¹¹ Çdo shoqëri e huaj që kishte vepruar në Shqipëri, do të fillonte t'i nënshtrohej një kontrolli të rreptë ekonomiko-financiar. I tillë do të ishte edhe fati i Shoqërisë Anonime Shqiptare Tregtare e Bujqësore (SASTEB) me qendër në Durrës, me urdhër të drejtpërdrejtë të ministrit të Ekonomisë, Medar Shtylla dhe me autorizim nga Kryeministria.¹² Shoqëria SASTEB merrej kryesisht me shpërndarjen dhe bluarjen e drithit që tërhiqej prej enteve të ndryshme, por shtetit të ri shqiptar nuk i interesonte më që shpërndarja e drithërave të kryhej nga firma private, kështu që, me vendim të komisionit hetimor ekonomiko-financiar të datës 22 tetor 1945, u vendos që firma e lartpërmendur të mbyllte përfundimisht llogaritë e saj financiare.¹³ Problem për qeverinë shqiptare ishte mbyllja e aktivitetit të shoqërisë së prodhimit të cigareve STAMLES (Shoqëria Tregtare Anonime për Monopolin e Letrave dhe Shkrepëseve) në Durrës, pasi kjo shoqëri më 29 mars 1945, kishte vendosur pezullimin e veprimtarisë së fabrikave dhe likuidimin e shumicës dërrmuese të personelit dhe këshilli administrativ i kësaj shoqërie kishte filluar menjëherë nga puna në zbatimin e këtij vendimi.¹⁴ Në vitin 1945, qeveria shqiptare nxori ligjin (pa datë e pa numër) mbi kontrollin nga ana e shtetit të industrive dhe shoqërive. Neni 1 i këtij ligji kreytësisht të pakuptimtë ishte:

"Të gjitha industritë dhe shoqëritë shqiptare vihen nën kontrollin e shtetit".¹⁵

¹¹ *Po aty*, fl. 5.

¹² *AQSH*, F. 490/KM, V. 1945, D. 144, fl. 1-2. Vendim dhe korrespondencë e Këshillit të Ministrave me Ministrinë e Ekonomisë, mbi formimin e një komisioni hetimor për shqyrtimin e punës së shoqërisë SASTEB.

¹³ *Po aty*, fl. 4.

¹⁴ *Po aty*, F. 490/KM, V. 1945, D. 145, fl. 4.

¹⁵ *Po aty*, F. 490/KM, V. 1945, D. 147, fl. 1. Mbi kontrollin nga ana e shtetit të industrive dhe shoqërive (firmave) shqiptare.

Evidencimet dhe problemet e para të afrimit ekonomik shqiptaro-jugosllav

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë e themeluar në vitin 1945,¹⁶ ishte një nga vendet e cila kishte vuajtur jashtëzakonisht shumë nga pushtimi nazifashist. Shkatërrimet e ndodhura gjatë Luftës së Dytë Botërore në atë vend ishin të mëdha. Për të pasur mundësi ringritjeje ekonomike edhe ai vend iu drejtua për ndihmë UNRRA-s. Jugosllavisë në periudhën prill 1945-qershor 1947 iu akorduan nga kjo organizatë 415.6 milionë dollarë.¹⁷ Në këtë vend ashtu si edhe në të gjitha vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, prania sovjetike ishte e dukshme dhe jo pak herë në këtë fillimpushteti jugosllavët do të ankoheshin për shfrytëzimin e ekonomisë së tyre prej sovjetikëve.¹⁸ Lideri jugosllav Tito që në fillimet e ushtrimit të pushtetit të tij kishte ngjallur dyshime tek udhëheqësi sovjetik, Stalin. Kjo për faktin se Titoja kishte krijuar një marrëdhënie të nderë në gjysmën e parë të vitit 1945 me fuqitë fituese të Perëndimit lidhur me çështjen e Triestes, qytet të cilin ai e kërkonte me çdo kusht që t'i mbetej Jugosllavisë.¹⁹ Për të mos u acaruar më tej, Stalini e kishte këshilluar Titon që të lejonte kthimin në atdhe përkohësisht të Mbretit Pjetër të Jugosllavisë dhe kur të vinte momenti i duhur t'i ngulte thikën pas shpine.²⁰ Koha tregoi se udhëheqësi jugosllav nuk e përfilli këtë këshillë të Stalinit. Ky ishte treguesi i parë që Titoja nuk do të ishte gjithmonë i prirë për të ndjekur çdo "këshillë" apo urdhër të Stalinit deri në vdekjen e këtij të fundit më 1953.²¹

Shqipëria e gjysmës së parë të vitit 1945 me gjithë politikat e gabuara ekonomike që ndoqi, ku më e rënda ishte shtetëzimi i çdo prone private dhe taksimet e jashtëzakonshme të tregtarëve shqiptarë, përsëri e

¹⁶ Ian Jeffries, *Socialist economies and the transition to the market; a guide* (London: Routledge, 1993), 317.

¹⁷ Unkovski-Korica, *The economic struggle*, 30.

¹⁸ Barbara Jelavich, *History of the Balkans. Twentieth Century*, Vol. 2 (New York: Cambridge University Press, 1983), 344.

¹⁹ Ian D. Armour, *A history of Eastern Europe 1918 to the present. Modernisation, Ideology and Nationality* (London: Bloomsbury Academic, 2021), 194.

²⁰ *Po aty*, 194-195.

²¹ Sheri Berman, *Democracy and Dictatorship in Europe. From the Ancient Régime to the present day* (New York: Oxford University Press, 2019), 321.

kishte të pamundur të mbijetonte ekonomikisht. Nëse marrim në shqyrtim marrëdhëniet me shtetet fqinje, me Greqinë situata për një bashkëpunim të mundshëm ekonomik ishte e pashpresë. Me Italinë, situata kishte hasur në ngërçe të mëdha financiare. I vetmi vend fqinj ku mund të mbështetej Shqipëria dhe që për momentin aplikonte të njëjtin sistem politik, ishte Jugosllavia e Titos. Në një informacion të datës 5 maj 1945, Banka e Shtetit Shqiptar njoftoi qeverinë shqiptare se Jugosllavia në muajin prill të po këtij viti kishte përfunduar unifikimin monetar të vendit, duke zëvendësuar të gjitha bankënotat që qarkullonin në vend (dinarë Nediç, kunas kroate, lira italiane, pengo hungareze, leva bullgare dhe franga shqiptare).²² E gjithë kjo manovër ishte kryer nga data 20 deri më 30 prill 1945 dhe monedha e re jugosllave, dinari, ishte emetuar prej shtetit dhe jo prej Bankës së Emisionit.²³ Monedha e re jugosllave ishte sipas raportit të bankës një titull shteti, pa konvertibilitet, perspektiva e së cilës në të ardhmen do të ishte njëlloj si ajo e biletave të shtetit. Po sipas raportit, kjo monedhë e re konsiderohej e përkohshme për të zgjidhur problemet ekonomike dhe financiare të momentit në Jugosllavi, dhe vetëm pas kësaj etape do të emetohej një monedhë e vërtetë dhe përfundimtare pa hequr këtu ndihmat financiare të jashtme.²⁴ Lidhur me frangën shqiptare, shkëmbimi nuk bëhej automatikisht, biletë për biletë, përveçse për shumat e vogla deri në 2000 franga.²⁵ Për shumat e mëdha të shkëmbimit, lëshohej vetëm një dëftesë mbi bazën e së cilës merrej vetëm pas tre muajsh kundërvlera në dinarë të rinj.²⁶

Interesant është fakti që na paraqet ky raport i Bankës së Shtetit se vlerën më të lartë të konvertimit dinari i ri jugosllav e kishte me frangën shqiptare [100 franga shqiptare=250 dinarë jugosllavë],²⁷ çka tregonte se me gjithë problemet ekonomike që kishte Shqipëria në gjysmën e parë të vitit 1945 dhe me gjithë politikat e gabuara ekonomike dhe financiare që

²² AQSH, F. 506/ Banka e Shtetit Shqiptar (BSHSH), V. 1945, D. 42, fl. 1. Raport mbi unifikimin monetar në Jugosllavi dhe mbi rrjedhjet e tij në tregun shqiptar.

²³ Po aty.

²⁴ Po aty.

²⁵ Po aty.

²⁶ Po aty, fl. 2. "Kursi i shkëmbimit i monedhës së re jugosllave sipas njoftimit shtetëror nëpërmjet radios ishte: 100 dinarë serbë=5 dinarë jugosllavë; 100 kuna kroate=2.50 dinarë jugosllavë; 100 lira italiane=30 dinarë jugosllavë; 100 pengo hungarezë=100 dinarë jugosllavë; 100 leva bullgare=10 dinarë jugosllavë; 100 franga shqiptare=250 dinarë jugosllavë".

²⁷ Po aty, fl. 2.

po ndiqte qeveria e re komuniste, përsëri monedha shqiptare ishte e qëndrueshme. Jo vetëm aq, por lira italiane në tregun jugosllav me dinarin e ri dilte super e vlerësuar ndërsa në tregun shqiptar të shkëmbimit, 100 lira italiane ishin të barabarta me vetëm 8,50 franga.²⁸ Për tregun shqiptar, kursi i caktuar për zëvendësimin e frangës shqiptare që qarkullonte në Kosovë dhe më tej deri në Shkup, ishte monedhë e fortë me baza të shëndosha e me vlerë konstante dhe kursi i këmbimit me dinarin e ri ishte 250 dinarë=100 franga shqiptare.²⁹ Me të drejtë Banka e Shtetit Shqiptar shtronte pyetjen: a i korrespondonte ky kurs çmimit real të tregut të frangës shqiptare dhe napolonit ar në Jugosllavi?³⁰ Përgjigjen e jep vetë raporti me një "Jo" të prerë me justifikimin se sipas lajmeve që kishin nga Beogradi përpara dy javëve, kursi i napolonit ar ishte ndërmjet 58 dhe 80 000 dinarë të vjetër dhe kishte pasur tendencë ngritjeje.³¹ Në Kosovë, sipas bankës, raporti i shkëmbimit në të gjithë atë periudhë ishte 1 napolon ar=70 000 dinarë, ndërsa me dinarët e rinj 1 napolon ar=3 000 dinarë.³² Kjo politikë e re që po ndiqte shteti jugosllav kishte sjellë zhvlerësimin e monedhës dhe arit shqiptar në favor të dinarit të ri. Sipas raportit, dinari i ri jugosllav nuk vlente as 40 të qindat e frangës shqiptare dhe rrjedhimisht franga shqiptare gjendej përpara një zhvlerësimi më shumë se masa 50% nga vlera e saj reale.³³

²⁸ *Po aty*. Pjesë nga raporti i Bankës së Shtetit: "Është për t'u nënvizuar se në bazë të këtij kursi, lira italiane del e sipërvlerësuar. Me të vërtetë ndërsa 100 lit. vlejné në tregun e lirë të Tiranës 8,50 fr. shq. gjithë ajo sasi lirash pranohet në Jugosllavi për 30 dinarë të rinj, pra për 12 fr. shq. Sa i takon levës bullgare kjo i përgjigjet vleftës së tregut të arit në Shkup e Tetovë ku 30.000 leva shkëmben për një napolon ari, dhe këto 30.000 leva bëjnë 3.000 dinarë të rinj".

²⁹ *Po aty*.

³⁰ *Po aty*.

³¹ *Po aty*, fl. 3.

³² *Po aty*.

³³ *Po aty*. "Megjithë këto, ne po marrim si bazë këtë çmim të fundit: 3.000 dinarë të rinj për një napolon ar. Sipas kursit të shkëmbimit zyrtar këta 3.000 dinarë duhet të vlejné 1.200 franga shqiptare (nga 40 qindarka të frangut shqiptar për 1 dinar të ri), po në realitet vlenin deri më 30 prill 1945 vetëm 610-615 fr. shqiptare, shumë me të cilën blihej 1 napolon ar në tregun shqiptar. Pra, efektivisht 1 dinar i ri jugosllav nuk vlen 40 (dyzet) qindar të frangut shqiptar, si e cakton kursi zyrtar por vetëm 20 (njëzet) qindar. Pra, gjendemi përpara një çvleftësimi të frangut në masë prej 50% nga vlefta e tij reale. Çështja ka për ne një rëndësi praktike të madhe, si ka për t'u parë më poshtë".

Vijimi i forcimit të lidhjeve dhe i aleancës me Jugosllavinë

Jugosllavia do të ishte në fillimet e pushtetit komunist shqiptar partneri më i afërt politiko-ekonomik për të mbajtur pushtetin. Servilizmi ndaj Jugosllavisë do të merrte përmasa të paimagjinueshme duke pasur parasysh historinë tepër të trazuar në marrëdhëniet jo vetëm ndërmjet dy shteteve, por edhe dy popujve. Nga hulumtimi i kujdesshëm i dokumenteve shihet se lidhshipi politik shqiptar, sidomos në gjysmën e parë të vitit 1946, ishte i detyruar për sa u përkiste marrëdhënieve me Jugosllavinë. Le ta shohim më konkretisht.

Më 3 maj 1946, Byroja Politike e KQ të PKSH-së mbajti një mbledhje urgjente ku do të diskutoheshin shqetësimet që kishte parashtruar Nako Spiru në telegramet e tij dërguar nga Beogradi.³⁴ Spiru ishte dërguar nga lidhshipi komunist shqiptar në Jugosllavi për të diskutuar rreth marrëveshjeve të mundshme ekonomike ndërmjet dy vendeve, por në vend që të informonte Byronë lidhur me to, lajmëronte se jugosllavët kishin këshilluar që të shtyhej Kongresi I i PKSH-së.³⁵ Kjo ishte një ndërhyrje e drejtpërdrejtë në punët e brendshme të partisë dhe të Shqipërisë, duke qenë se PKSH-ja po e identifikonte veten përherë e më shumë me vendin dhe për këtë nuk jepej asnjë arsye e besueshme. Ndërsa për çështjet më të rëndësishme, lidhur me marrëveshjet ekonomike, Spiru njoftonte se kishin ngecur në vend.³⁶ Në telegram, Spiru gjithashtu shkruante se jugosllavët i kishin bërë dhe po i bënë bisedimet sipas interesave të tyre.³⁷

Çështja e marrëdhënieve me Jugosllavinë kishte marrë një karakter për jetë a vdekje për udhëheqjen dhe qeverinë komuniste shqiptare. Të shqetësuar nga informatat që kishte dërguar Spiru nga Beogradi, më 21 maj 1945, Byroja Politike e KQ të PKSH-së organizoi një mbledhje të veçantë ku u diskutuan pikat e marrëveshjeve të mundshme ekonomike

³⁴AQSH, F. 14/ Organet Udhëheqëse (OU), V. 1946, D. 7, fl. 1. Mbledhja e Byrosë Politike e datës 3 maj 1946, në lidhje me përmbytjen e telegrameve dërguar nga Nako Spiru mbi ndërhyrjet e Jugosllavisë në çështjet e brendshme politike të Shqipërisë.

³⁵Po aty.

³⁶Po aty, fl. 2.

³⁷Po aty.

me fqinjin verior.³⁸ Në diskutimin e tij, Kiço Ngjela* kishte deklaruar se drafti i marrëveshjes ekonomike ishte formal dhe kishte shfaqur dyshime veçanërisht për nenin 4, për dhënien e 2 000 000 000 dinarëve kredi pa kamatë që ishte e paprecizuar dhe në këtë mënyrë nuk mund të firmosej.³⁹ Një tjetër element që të bënte të dyshoje në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje ishte edhe diskutimi lidhur me çmimet unike, të cilat Boris Kidriç (Kidrič) kryetar i Këshillit Ekonomik Jugosllav i kishte thënë Enver Hoxhës se "nuk do të kishte çmime unike, por vetëm strukturë unike".⁴⁰ Kiço Ngjela, i pranishëm në diskutimet që ishin zhvilluar në Beograd, i kishte deklaruar Kidriçit se meqenëse Shqipëria do t'i blinte mallrat në Jugosllavi, çmimet normalisht nuk do të ishin njëlloj, pasi do të paguheshin më shtrenjtë.⁴¹ Ngjela kishte kundërshtuar që nga shuma e kredisë prej 2 miliardë dinarësh, Shqipëria të mbante rezervë 300 milionë pasi çmimet ishin parashikuar të ishin shumë të larta dhe për këtë arsye kishte rekomanduar të mbaheshin rezervë vetëm 100 milionë.⁴² Lidhur me vërejtjet e paraqitura nga Kiço Ngjela, edhe vetë Enver Hoxha ishte dakord ashtu si e gjithë pjesa tjetër e Byrosë Politike që të hiqej neni 4 i akordit tregtar.⁴³

Qeveria shqiptare nuk kishte rrugë tjetër për të mbijetuar ekonomikisht dhe rrjedhimisht politikisht pa "u falur" te Jugosllavia. Me anë të një akordi tregtar të firmosur në Beograd më 1 korrik 1946, shteti jugosllav pranonte t'i jepte Shqipërisë një kredi prej 1 200 000 dollarë (2 mld dinarë) dhe me anë të kësaj kredie Shqipëria ishte e detyruar që të

³⁸ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1946, D. 8, fl. 10. Mbledhje e Byrosë Politike e KQ të PKSH-së lidhur me marrëveshjet ekonomike me Jugosllavinë.

* *Kiço Ngjela* (25 dhjetor 1917 - 16 qershor 2002). Më 1945, anëtar i Asamblesë Kushtetuese dhe më 1945-1946 ndihmësinistër i Ekonomisë.

³⁹ *Po aty*.

⁴⁰ *Po aty*.

⁴¹ *Po aty*.

⁴² *Po aty*, fl. 11. Pjesë nga rekomandimi i Kiço Ngjelës: "Kiço tha se 300 milion është shumë si rezervë pse edhe çmimet janë parashikuar shumë të larta prandaj të liresh vetëm 100 milion. Ata thanë se nuk mund të shtohesh asgjë, u shtuan vetëm 20 traktorë e 10 makina shirëse, tjetër gjë tani s'japim gjë që do ta studiojmë nëse mund të shtojmë diçka në manifakturë. Realizimi i materialit gjatë këtij viti është shumë i zorshtëm. Nga 480.000.000 importimi është zor të realizohen të gjitha pse porositë janë bërë tani dhe është zor të gjenden. Prandaj duhet të rishqyrtojmë planin dhe të lëmë rezervë".

⁴³ *Po aty*, fl. 12.

gjitha mallrat t'i blinte në Jugosllavi.⁴⁴ Kushtet e kredisë që qeveria shqiptare firmosi ishin tepër të rënda. Sipas marrëveshjes, kredia duhej të shlyhej për pesë vjet duke filluar nga viti 1948 në pesë këste vjetore dhe përqindja e interesit që duhej paguar ishte 3%.⁴⁵

Marrëdhëniet me Jugosllavinë do të ishin të veçanta për hir të interesit të pushtetit personal të Enver Hoxhës. Më datë 6 gusht 1946 me ligjin nr. 272, Kuvendi i Shqipërisë dekretoi ratifikimin e Traktatit të Miqësisë dhe Ndhimës Reciproke ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë.⁴⁶ Ky traktat që ishte firmosur së pari në Tiranë më 9 korrik 1946 nga Kryeministri dhe ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Enver Hoxha, dhe nga ministri i Jashtëm jugosllav, Stanoje Simić (Simić),⁴⁷ e vendoste totalisht Shqipërinë nën tutelën e Jugosllavisë, një arritje kjo për shtetin jugosllav që nuk e kishte arritur edhe kur kishte pasur mbështetjen e Fuqive më të Mëdha të Europës. Atë që Jugosllavia nuk ia kishte dalë ta bënte me luftë për të gllabëruar Shqipërinë, tashmë po ia dilte mbanë duke përdorur armën më efikase të të gjitha kohërave: ekonominë. Vetë neni 1 i kësaj marrëveshjeje e thoshte qartë se, të dyja vendet kishin rënë dakord të forconin edhe më tepër marrëdhëniet miqësore që ekzistonin me një bashkëpunim të vazhdueshëm, të ngushtë dhe të gjithanshëm.⁴⁸

Në lidhjen me Jugosllavinë, qeveria shqiptare po përmbyste një traditë shekullore në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. Tashmë, kjo situatë për interesat e ngushtë të Enver Hoxhës dhe të PKS-së, do të ndryshonte katërçipërisht. Në një njoftim dërguar Ministrisë së Jashtme, më 14 gusht 1946, instruktohej të mbahej një qëndrim dashamirës ndaj

⁴⁴ *Arkivi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme*, Fondi MPJ (më tej: *AMPJ*), Viti (më tej: V.) 1946, Dosja (më tej: D.) 113, fl. 6. Akord mbi kredinë që qeveria e RFPJ-së i jep qeverisë së RPSH-së. Firmosur në Beograd nga Nikolla Petroviç dhe Nako Spiru.

⁴⁵ *Po aty*, fl. 6-7. "Qeveria e RPSH do të paguajë për kredinë e dhënë në fund të çdo viti dhe duke filluar nga 1948 një kamatë prej 3% në vit...Kthimi i kamatës do të bëhet qoftë me dhënie mallrash, qoftë me dollarë USA në konformitet të artikullit 3 të këtij akordi".

⁴⁶ *Po aty*, F. 490/KM, V. 1946, D. 119, fl. 1. Ligj mbi ratifikimin e Traktatit të Miqësisë dhe Ndhimës Reciproke ndërmjet RPSH-së dhe RSFJ-së; shih edhe *AMPJ*, V. 1946, D. 112, fl. 49. Ratifikimi i Traktatit të Miqësisë ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, nënshkruar në Tiranë më 9 korrik 1946.

⁴⁷ *Po aty*, fl. 3.

⁴⁸ *Po aty*, fl. 2.

shteteve sllave në Ballkan e, mbi të gjitha, ndaj Komitetit pansllav.⁴⁹ Në këtë instruksion shënohej se "miqtë më të shëndoshë të Shqipërisë janë popujt sllavë".⁵⁰ Për këtë arsye, Shqipëria duhej të ecte krah për krah me Jugosllavinë dhe Bullgarinë, pasi ishin vendet që "na mbronin shpatullat".⁵¹

Marrëdhënia e ngushtë për momentin mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, që në fakt shkante deri në servilizëm dhe nënshtrim e deri në përçmim të vetvetes nga ana e qeverisë shqiptare, kërkonte përtej çdo dyshimi një shpjegim "të besueshëm" jo vetëm për qarqet e larta dhe të ulëta drejtuese të PKSH-së, por edhe për të gjitha strukturat e partisë. Duke marrë parasysh se çfarë kishte ndodhur gjatë gjithë vitit 1946, më datë 15 dhjetor, Komiteti Qendror i PKSH-së me anë të Koçi Xoxes, u drejtoi një letër të hapur të gjitha strukturave ku udhëzonte se si duhej kuptuar marrëdhënia e ngushtë Shqipëri-Jugosllavi dhe mbi të gjitha marrëveshjet ekonomike me shtetin fqinj verior.⁵² Në këtë letër, KQ-ja përpiqej të shpjegonte sa më "hapur" rëndësinë e bashkëpunimit ekonomik me Jugosllavinë si pasojë e gjendjes politike dhe ekonomike me të cilën duhej të përballej Shqipëria pas çlirimit.⁵³ Ekonomia shqiptare pas luftës, nuk kishte mundur të zhvillohej dhe të ecte përpara, sikurse ndodhi me pushtetin politik.⁵⁴ Këtu kemi një paradoks. Në çdo sistem politik normal, është ekonomia që përcakton çfarë sistemi politik do të përkrahë për të pasur më shumë progres. Në Shqipëri ndodhi pikërisht e kundërta. Ishte politika që vendosi se çfarë sistemi ekonomik do të ndiqej dhe jo cili do të ishte interesi i vendit sipas parimeve të tregut.

Komiteti Qendror (KQ) i Partisë Komuniste Shqiptare, e quante regjimin që kishte instaluar në Shqipëri të përparuar, ndërsa ekonominë shqiptare të prapambetur e cila nuk kishte ecur sinkron me këtë pushtet kaq "përparimtar".⁵⁵ KQ-ja përpiqej të shpjegonte se përse duhej ngritur

⁴⁹ *AMPJ*, V. 1946, D. 78, fl. 1. Mbi marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë dhe letër e Koço Tashkos dërguar Ministrisë së Jashtme.

⁵⁰ *Po aty*.

⁵¹ *Po aty*, fl. 2.

⁵² *AQSH*, F. 14/Strukturë (Str.), V. 1946, D. 171/1, fl. 242. Mbi marrëveshjet ekonomike të nënshkruara ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federale Popullore të Jugosllavisë.

⁵³ *Po aty*.

⁵⁴ *Po aty*.

⁵⁵ *Po aty*.

një ekonomi kombëtare e fuqishme, e cila të mund të ecte paralel me pushtetin politik në vend, por që në kushtet e Shqipërisë konsiderohej një barrë e rëndë për t'u arritur vetëm duke u mbështetur në forcat e brendshme [forcat tona] dhe për këtë arsye duhej ndihma ekonomike e Jugosllavisë.⁵⁶ Marrëveshjen ekonomike me Jugosllavinë, KQ-ja e quante ngjarje me rëndësi të madhe politike dhe një mbështetje për të ngritur fuqinë ekonomike të Shqipërisë e cila do të ishte një siguri për të ardhmen e vendit.⁵⁷ Për t'ia arritur kësaj, ishte e domosdoshme sipas kësaj letre që ndërmjet dy vendeve të koordinoheshin planet ekonomike, ku nga ana e saj Shqipëria do të luftonte edhe më radikalisht ekonominë kapitaliste dhe mbeturinat e ekonomisë feudale e në këtë mënyrë synohej të zhdukej disnivele ndërmjet regjimit politik dhe gjendjes ekonomike të prapambetur.⁵⁸ Edhe më e rëndë nga ana logjike, në përpjekjen e KQ-së për të shpjeguar marrëveshjen ekonomike me Jugosllavinë, ishte se "qartësimi" i saj nuk duhej bërë mbi baza ekonomike mbi atë se çfarë fitonte apo humbte Shqipëria, por mbi baza ideologjike!⁵⁹

Justifikimi i parë që KQ-ja shtronte për kuptimin drejt të kësaj marrëveshjeje, ishte se të dyja vendet në kohën e luftës kishin qenë të pushtuara nga i njëjti okupator dhe populli shqiptar dhe jugosllav kishin qenë të shtypur prej klikave reaksionare.⁶⁰ Marrëdhëniet e reja të vendosura ndërmjet dy vendeve ishin totalisht me baza socialiste (joekonomike), të cilat mund të ekzistonin vetëm në vendet ku kishte triumfuar socializmi nën shembullin e Bashkimit Sovjetik.⁶¹ Jo vetëm kaq, por KQ-ja theksonte fort se kjo marrëveshje ekonomike ishte paraprirë nga një aleancë ushtarake nëpërmjet së cilës Jugosllavia i siguronte popullit shqiptar pavarësinë kombëtare.⁶² Dukej qartë se

⁵⁶ *Po aty*.

⁵⁷ *Po aty*.

⁵⁸ *Po aty*, fl. 242.

⁵⁹ *Po aty*.

⁶⁰ *Po aty*.

⁶¹ *Po aty*, fl. 243.

⁶² *Po aty*. Pjesë nga letra e KQ-së: "Marrëveshja jonë ekonomike me Jugosllavinë F.P. nuk duhet të kuptohet si një gjë e rastit. Jo. Ajo duhet të dalë se është në rrugën e drejtë dhe të vetme që ka ndjekur dhe ndjek populli ynë, në rrugën e zhvillimit e të përparimit. Kjo është politika e masave të popullit tonë. Në fillim ne luftuam bashkë kundër okupatorëve e armiqve të përbashkët. Dje u bë aleanca ushtarake e cila i siguron popullit tonë Indipendencën kombëtare. Sot marrëveshja i siguron popullit

regjimi i paaftë politik i Enver Hoxhës po e vendoste fatin e Shqipërisë në duart e Jugosllavisë. Madje, marrëzia për ta lartësuar këtë marrëveshje, shkoi edhe më tej kur KQ-ja deklaroi hapur se kjo marrëveshje duhej të kuptohej qartazi prej popullit shqiptar, si një vepër largpamëse e udhëheqjes së PKSH-së që pati mençurinë të gjente këtë lloj mbështetjeje në udhëheqjen e Jugosllavisë Federale Popullore.⁶³

Shqipërisë duhej t'i shpjegohej mirë roli i madh i luajtur prej partisë dhe kjo marrëveshje i kushtohej orientimit të saj të drejtë, por pa mohuar se kjo politikë ekonomike bëhej me synim forcimin e pushtetit të Frontit dhe për një të ardhme të sigurt.⁶⁴ Ishte e qartë përtej çdo dyshimi se pushteti komunist sado represiv e gjakatar që të tregohej do ta kishte të pamundur jetëgjatësinë, nëse nuk arrinte të gjente mënyra që vendi të mbijetonte ekonomikisht. Marrëveshja ekonomike me Jugosllavinë ishte në radhë të parë një garanci për pushtetin absolut të Enver Hoxhës dhe jo për mirëqenien e popullit. Vetë ministri i Brendshëm, Koçi Xoxe, si nënshkruesi i kësaj letre, udhëzonte qarqet që të bënin ç'ishte e mundur nga ana propagandistike që masat ta kuptonin se kjo marrëveshje ishte "e tyrja"; se do të kishte rezultate të shpejta; se do të përmirësohej gjendja e tyre ekonomike dhe e bënte të ardhmen më të sigurt.⁶⁵

Përpara këtij akordi, për ta vënë Shqipërinë edhe më tepër nën tutelën e saj ekonomike, më 2 nëntor 1946 ishte firmosur akordi ndërmjet Nikolla Petroviçit dhe Nako Spirut* në Beograd për themelimin e Bankës

tonë ngritjen ekonomike, dhe një të ardhme më të mirë e më të sigurtë. Për popullin tonë nuk ka e nuk mund të ketë rrugë tjetër".

⁶³ *Po aty*, fl. 243-244.

⁶⁴ *Po aty*, fl. 244.

⁶⁵ *Po aty*. "Mbi të gjitha është e rëndësishme që masat e popullit të jenë të qarta se kjo marrëveshje është e tyrja, se do të ketë rezultate të shpejta, se përmirëson gjendjen e tyre ekonomike sot dhe e bën të sigurtë të ardhmen e tyre. Sqarimi i masave, i drejtë dhe i shëndoshë është puna kryesore dhe e domosdoshme e Partisë, pa bërë filozofi dhe pa bërë shumë histori. Kjo është një vepër konkrete me anën e së cilës ne po konkretizojmë vijën e bashkëpunimit tonë politik në lëmin e ekonomisë, vijën e Partisë tonë. Kjo marrëveshje është rezultat i orientimit tonë, tek ky orientim populli ynë duhet të shikojë të qartë perspektivat e tij, të jetë koshient për rrugën në të cilën ai po ecën dhe për një afrim e bashkëpunim sa më të ngushtë me popujt e Jugosllavisë F.P. Kështu me gjakftohtësi e me arsytim t'iu shpjegojmë edhe atyre që nuk e kuptojnë".

* *Nako Spiru* (4 janar 1918-20 nëntor 1947). Më 1945 - Sekretar i Sekretariatit të Frontit; më 1945-1947 - anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Frontit; më 1946 - deputet dhe sekretar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, ministër i Ekonomisë; më 1947 - ministër i Industrisë, kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit dhe kryetar i Këshillit Ekonomik.

Shqiptaro-Jugosllave, e financuar tërësisht me kapital jugosllav e cila do të kishte një kohëzgjatje prej 30 vjetësh.⁶⁶ Kapitali fillestar i kësaj banke do të ishte 60 000 000 franga shqiptare, të cilat sipas marrëveshjes së nënshkruar do të ishin të patransferueshme.⁶⁷

Lidhur me marrëveshjen e mësipërme, më 13 dhjetor 1946, Tirana zyrtare njoftoi legatën e saj në Moskë, që të njihej me detajet e asaj çfarë ishte arritur ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë.⁶⁸ Në të njëjtën ditë, në Tiranë u botua një shpallje ku "justifikohej" rëndësia e marrëveshjes me Jugosllavinë, si dhe benefitet që do të kishte Shqipëria prej saj.⁶⁹

Më 18-20 dhjetor 1946 për të "sqaruar" partinë dhe popullin mbi konventën ekonomike të nënshkruar në Beograd më 27 nëntor 1946 mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, u mbledh Plenumi i jashtëzakonshëm i KQ të PKS-së ku u diskutuan pikat e mëposhtme të kësaj konvente:

1. Koordinimi i planeve ekonomike ndërmjet dy vendeve;
2. Heqja e kufirit dhe e taksave doganore;
3. Parifikimi i monedhës shqiptare me atë jugosllave.⁷⁰

Konventa ekonomike e nënshkruar më 27 nëntor 1946, përcaktonte koordinimin e planeve ekonomike mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë dhe kjo e fundit do të duhej të ecte sipas planit të hartuar nga Beogradi për t'u zhvilluar ekonomikisht.⁷¹ Konventa ekonomike eliminonte në të vërtetë çdo liri financiare të Shqipërisë duke nënshtruar monedhën shqiptare ndaj asaj jugosllave që në fakt në rezolucion quhej "paritet",⁷² por dihej mirë që nuk ekzistonte asnjë lloj barazie ndërmjet dy monedhave, pasi leku shqiptar nuk ishte në asnjë rast i konvertueshëm në bursat botërore.

⁶⁶ *AMPJ*, V. 1946, D. 115, fl. 1-3. Marrëveshje mbi krijimin e Bankës Shqiptaro-Jugosllave.

⁶⁷ *Po aty*, fl. 2.

⁶⁸ *Po aty*, V. 1946, D. 114, fl. 6. Njoftim legatës shqiptare në Moskë mbi marrëveshjen e arritur ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

⁶⁹ *Po aty*, fl. 8.

⁷⁰ *AQSH*, F. 14/Str., V. 1946, D. 171/1, fl. 247. Njoftim mbi rezolucionin e Plenumit të jashtëzakonshëm të KQ-së, më 22 dhjetor 1946; shih edhe *po aty*, F. 14/OU, V. 1946, D. 4, fl. 42-43. Procesverbal, dorëshkrime në dy variante dhe rezolucioni i mbledhjes së jashtëzakonshme të Plenumit të KQ të PKS-së, më 18-20 dhjetor 1946, për vënien në dijeni të kuadrove dhe qarqeve mbi konventën ekonomike të nënshkruar në Beograd më 27 nëntor 1946 ndërmjet Jugosllavisë e Shqipërisë.

⁷¹ *Po aty*.

⁷² *Po aty*.

Gjendja ekonomike e Shqipërisë gjatë vitit 1946 dhe paarsyeshmëria ekonomike e lidhjes së ngushtë me Jugosllavinë

Shqipëria po kalonte një fazë tepër të vështirë për sektorin e tregtisë dhe të furnizimeve dhe mungesat në treg po bëheshin gjithnjë e më të mëdha. Gjithashtu, shitja kontrabandë e floririt kishte ulur edhe më shumë besimin e popullsisë te monedha e re.⁷³ Duke u ndërjegjegësuar dita-ditës mbi pamundësinë e rritjes ekonomike të vendit, edhe pse kishin kaluar dy vjet nga çlirimi i Shqipërisë, Banka e Shtetit Shqiptar paraqiti një studim lidhur me lëvizjen grafike të rrogave të paguara nëpunësve nga viti 1939 deri më 31 dhjetor 1946.⁷⁴ Rrogat që u morën në shqyrtim ishin ato të kategorive për nëpunësit e transporteve, tregtisë, ndërtimeve e industrisë dhe për pesë kategori për nëpunësit e shtetit dhe të bankës. Vetë studimi e pranonte se këto kategori kishin pasur rroga të larta nga viti 1939, por ishin zvogëluar pas vitit 1945.⁷⁵ Viti 1946 sipas studimit të bankës, kishte rezultuar si viti më i dobët për sa i përkiste uljes së rrogave, por justifikohej me ndryshimin që i ishte bërë monedhës.⁷⁶ Studimi nuk mund ta fshihte edhe pse u mundua ta ulte në minimum dëmin që kishte pësuar shteti shqiptar si pasojë e orientimeve të gabuara ekonomike, duke konstatuar se për periudhën 1945-1946 kostoja e jetesës "zbret me një përqindje të vogël".⁷⁷ Duke parë me kujdes të gjitha provat që kemi paraqitur në pjesët e artikullit, shihet qartë se politikat e gabuara të lidhshimit dhe të qeverisë komuniste po sillnin pasojat tepër të dhimbshme ekonomike për Shqipërinë. Sikur të mos mjaftonin këto, lidhja e ngushtë e gjithanshme dhe mbi të gjitha ekonomike që Enver Hoxha do të bënte si drejtues i shtetit me Jugosllavinë ishte një tjetër faktor që e rëndoi ekonominë e vendit deri në nënshtrimin e plotë ndaj shtetit jugosllav. Lidhur me këtë çështje, vetë Banka e Shtetit Shqiptar në

⁷³ AQSH, F. 14/Str., V. 1946, D. 165, fl. 12. Raporte mbi gjendjen e aplikimit të Reformës Agrare, rindërtimin e shtëpive të djegura, shkollave, tregtia dhe furnizimet.

⁷⁴ Po aty, F. 506/BSHSH, V. 1946, D. 50, fl. 1. Statistika rrogash 1939-1940.

⁷⁵ Po aty, fl. 2.

⁷⁶ Po aty. Pjesë nga studimi i bankës: "Në faqen 7 kemi numrat tregues të rrogave në periudhën 31 mars 1939 deri 31 dhjetor 1946. Të gjitha rrogat pësojnë një ngritje të madhe në vitin 1945 dhe një zbritje në vitin 1946 që i determinohet ndryshimit të monedhës".

⁷⁷ Po aty, fl. 4.

një studim të kryer në vitin 1946, pranonte se monedha shqiptare [franga] ishte më e fuqishme në kursin e këmbimit ndaj dinarit jugosllav në shifrat 1 fr.shq.=9 din. jugosllavë.⁷⁸ Goditja ndaj rezervave monetare me politikat e gabuara të ndjekura që në fillim të vitit 1945 e kishte paraqitur ekonominë e Shqipërisë veçanërisht sektorin industrial totalisht të dobët përpara atij jugosllav. Tregues ishte se tregtimi i mallrave ushqimore dhe pagesat e tyre në dinarë ishin favorizues për Jugosllavinë dhe dëmtues për Shqipërinë. Sipas prezantimit dhe krahasimit të çmimeve në dinarë jugosllavë dhe franga shqiptare të bëra nga Banka e Shtetit, tregohej qartë se raporti i jetesës dhe i çmimeve ndërmjet dy vendeve ishte më i shtrenjtë në Shqipëri.⁷⁹ Ky fakt kishte bërë që në Shqipëri (sigurisht fshehtas) të lulëzonte deri diku tregu i zi i këmbimit të arit dhe i dollarit amerikan në të cilin, sipas raportit të bankës më 7 shtator 1946, ari kuotohej 417% më shtrenjtë nga kursi zyrtar dhe dollari amerikan 200% më shtrenjtë.⁸⁰ Ky raport, po të krahasohej me atë të Jugosllavisë, tregonte se ari në Shqipëri kuotohej më shumë se në Jugosllavi nga 143,8% deri në 167,8% më shumë dhe jetesa ishte 169,7% më e shtrenjtë se në Jugosllavi.⁸¹

Një tjetër gabim i rëndë që kishte bërë qeveria komuniste shqiptare në politikat e saj financiare ishte edhe përcaktimi i kursit në rubla, duke e ditur fare mirë siç e tregon raporti i bankës se monedha sovjetike nuk kuotohej në asnjë vend të botës.⁸² Me anë të pasqyrimin të konvertimit të monedhave për muajin mars të vitit 1946 nga Banka e Shtetit, duket qartë se rubla nuk ishte e këmbyeshme me asnjë nga monedhat e rëndësishme në tregun botëror të arit.⁸³ Dukej sikur qeveria komuniste shqiptare dëshironte me ndërgjegje të plotë të "varroste" ekonomikisht vendin

⁷⁸ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1946, D. 52, fl. 1. Studim i Bankës së Shtetit Shqiptar mbi shpenzimet ushqimore dhe kursin e këmbimit.

⁷⁹ *Po aty*, fl. 3-4.

⁸⁰ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1946, D. 55, fl. 4. Raport i Bankës së Shtetit Shqiptar mbi kuotimin e monedhave.

⁸¹ *Po aty*.

⁸² *Po aty*, fl. 5. "Rubla në asnjë vend të botës nuk kuotohet, mbasi Bashkimi Sovjetik vetë deri më sot e ka konsiderue Rublën si një monedhë të mbrendshme. Politika monetare e Bashkimit Sovjetik ka shumë ndryshime me politikën monetare të vendeve kapitaliste".

⁸³ *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1946, D. 76, fl. 1. Mbi tregun e arit dhe të valutave të huaja në Shqipëri.

vetëm për të ndërtuar socializmin sipas "mësimeve" të vyera të Bashkimit Sovjetik.

I paimagjinueshëm por i vërtetë, ishte fakti se Jugosllavia nuk përdorte rublën si mjet këmbimi, por frangën franceze pasi ishte një monedhë e konvertueshme në tregjet ndërkombëtare.⁸⁴ Jo vetëm atë, por Jugosllavia përdorte çdo monedhë të fuqishme perëndimore që kishte pasur traditë në kurset ndërkombëtare të këmbimit (sterlinën angleze, frangën belge, frangën zvicerane) dhe kishte vendosur paritet të këmbimit të arit me SHBA-në 1 kg ar fino=56 000\$.⁸⁵ Duke pasur rublën si kurs bazë këmbimi, Shqipëria ishte në prag të fundosjes ekonomike. Guxoj të bëj pyetjen: "pse vallë" kjo politikë kaq e gabuar ekonomike e qeverisë komuniste shqiptare, por përgjigjen e jep vetë studimi i bankës duke deklaruar se, "nëse politika e importimeve do të jetë e tillë, në fund do të rezultojë një deficit i madh të cilin ne nuk mund ta përballojmë dhe nga ndryshimet e kurseve të dy monedhave mund të rrezikohet humbje devize".⁸⁶ Nëse politika ekonomike e qeverisë do të ishte mbështetur te këmbimi i monedhës me monedhat perëndimore siç po bënte Jugosllavia, vetë raporti e pranonte se monedha shqiptare do të kishte një kuotim me botën e jashtme dhe do të njiheshin edhe kurset e brendshme të këmbimit.⁸⁷ Gjithashtu, Ministria e Ekonomisë do të bënte të mundur që të gjitha importet për llogari të shtetit të përballoheshin nga monedha e brendshme lokale, duke e konsideruar atë me fuqi blerëse dhe rrjedhimisht importet shqiptare do të kushtonin më lirë.⁸⁸

Vetë studimi i bankës e pranonte se vendosja e kursit të këmbimit në bazë të fuqisë blerëse ishte i disfavorshëm për Shqipërinë dhe, mbi të gjitha, nuk ishte i saktë.⁸⁹ Kjo, për faktin se politika e një vendi për sa i përket konsumit të brendshëm ndryshonte shumë nga ajo e një vendi tjetër dhe në lidhje me këtë çështje, studimi merrte si shembull frangën zvicerane. Kështu, në Zvicër, jetesa ishte shumë e shtrenjtë krahasuar me vendet e tjera të Europës, por franga zvicerane gjithashtu ishte më e fortë

⁸⁴ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1946, D. 55, fl. 9.

⁸⁵ *Po aty*, fl. 11.

⁸⁶ *Po aty*, fl. 15.

⁸⁷ *Po aty*.

⁸⁸ *Po aty*.

⁸⁹ *Po aty*, fl. 16. Pjesë nga studimi i bankës: "Caktimi i kursit të dy monedhave në bazë të fuqisë blerëse sipas mendimit tonë jo vetëm që asht i disfavorshëm për ne, por nga ana tjetër nuk asht i saktë".

se monedhat e vendeve të tjera.⁹⁰ Kjo do të thoshte se fuqia e brendshme e çdo shteti ishte relative dhe varej nga shumë faktorë, të cilët shpeshherë ishin artificialë dhe nuk tregonin fuqinë reale të monedhës.⁹¹ Sipas studimit, fuqia blerëse e vendit nuk mund të merrej për bazë.

Studimi i bankës nuk mund ta fshihte faktin se përpara vitit 1939 monedha shqiptare kishte një fuqi blerëse të jashtme shumë të fortë, megjithëse fuqia blerëse e brendshme ishte shumë më e vogël krahasuar me atë të dinarit jugosllav.⁹² Ishte e pamundur të vendosje shenjën e barazimit ndërmjet një popullsie 20 milionë banorëshe dhe një popullsie 1 milion banorëshe. Ishte thjesht keqlllogaritje me dëshirë. Nga hulumtimi i këtij studimi profesional, ekspertët që e kishin hartuar atë, këshillonin qeverinë që, në bazë të kursit të këmbimit frangë shqiptare dhe dinar jugosllav të merrej dollari amerikan dhe kursi zyrtar i arit në të dyja vendet.⁹³ Po ashtu, duhej të merrej mirë parasysh edhe niveli i kostos së jetesës për të dyja vendet, nga viti 1939 deri në vitin 1946.

Për sa i përkiste këmbimit ndërmjet frangës shqiptare me dollarin, monedha shqiptare ishte më e avantazhuar ndaj dinarit jugosllav.⁹⁴ Nga ky fakt rridhte se 100 dinarë jugosllavë ishin të barabartë me 5.54 franga shqiptare.⁹⁵ Po ashtu, krahasuar me kursin e këmbimit me arin përsëri franga shqiptare ishte më e avantazhuar.⁹⁶ Nga ky raport rezultonte se 100 dinarë ishin të barabartë me 5.51 franga shqiptare.⁹⁷ Kjo tregonte se Shqipëria në marrëdhëniet tregtare me Jugosllavinë duhej të merrte për bazë jo koston e jetesës, por kursin e këmbimit me arin dhe dollarin. Nëse do të merrej për bazë kostoja e jetesës, Shqipëria do të duhej të paguante shumë më tepër pasi niveli i jetesës i Jugosllavisë ishte disa herë më i shtrenjtë sesa në Shqipëri, dhe nga viti 1939 deri në vitin 1946 kostoja e jetesës në atë vend ishte rritur 7.85 herë.⁹⁸

Dëmi që po i shkaktonte vendit politika ekonomike e qeverisë ishte i madh. Do të ishte e pamundur ta rindërtoje Shqipërinë në një kohë kur

⁹⁰ *Po aty.*

⁹¹ *Po aty.*

⁹² *Po aty.*

⁹³ *Po aty*, fl. 17.

⁹⁴ *Po aty.* 1 USD = 2.77 franga shqiptare; 1 USD = 50 dinarë jugosllavë.

⁹⁵ *Po aty.*

⁹⁶ *Po aty*, fl. 18. 1 kg ar i thjeshtë 1000/1000 dinarë 56.300; 1 kg ar i thjeshtë 1000/1000 fr. = 3.100.

⁹⁷ *Po aty.*

⁹⁸ *Po aty*, fl. 19.

leadershipi komunist po dëmtonte dita-ditës monedhën e vendit. Një detaj i rëndësishëm që na paraqitet duke hulumtuar këtë dokument të bankës, ishte edhe fakti se që në fillim të vitit 1939, franga shqiptare ishte e barabartë me një frang ar me përmbajtje gram ar 0.290322.⁹⁹ Ky lloj pariteti ishte bërë i mundur pasi qarkullimi i monedhës ishte i garantuar të paktën nga një e treta në ar ose në deviza të huaja lirisht të shkëmbyeshme në ar.¹⁰⁰ Në vitin 1939, qarkullimi arrinte në 11 939 000 franga ari dhe rezerva në ar dhe devizat e huaja të shkëmbyeshme në ar ishin 7 573 000 franga ari.¹⁰¹ Nga këto shifra rezultonte se pariteti frangë ari me frangë shqiptare ishte i siguruar.

Varësia totale ekonomike e Shqipërisë ndaj Jugosllavisë në gjysmën e parë të vitit 1947

Viti 1947 u hap me një incident të pakëndshëm në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Më datë 19 janar 1947, bateritë ushtarake bregdetare shqiptare kishin hapur zjarr ndaj dy anijeve jugosllave "Srečko" dhe "Otac Petar" të cilat po udhëtonin nga Greqia në drejtim të brigjeve jugosllave, çka ishte konfirmuar edhe nga agjencia detare jugosllave me seli në Durrës dhe pala shqiptare ishte justifikuar se anijet që po udhëtonin në ujërat shqiptare nuk i kishin njohur.¹⁰² Pas një note proteste nga legata jugosllave në Tiranë dhe ndjesës së menjëhershme të autoriteteve shqiptare, incidenti u konsiderua i mbyllur.¹⁰³ Politika e jashtme e Shqipërisë në këtë vit ishte e përqendruar më së shumti te marrëdhëniet me Jugosllavinë. Në mars të vitit 1947, do të lëvroheshin nga Jugosllavia sipas marrëveshjes së dhjetorit të vitit 1946 ndërmjet dy

⁹⁹ *Po aty*, fl. 23.

¹⁰⁰ *Po aty*.

¹⁰¹ *Po aty*, fl. 23.

¹⁰² *AMPJ*, V. 1947, D. 111, fl. 6. Dokumente për incidente kufitare në kufijtë e dy vendeve.

¹⁰³ *Po aty*, fl. 7. "...Departamenti i Mbrojtjes Kombëtare të Shqipërisë shpreh keqardhjen e thellë për incidentin e ndodhur dy anijeve jugosllave "Srečko" dhe "Otac Petar"-Stomorska më datë 19 janar 1947. Në ndjekje të njoftimeve të incidentit të 19 janarit 1947, lajmërojmë se ajo që ndodhi ishte për shkak të keqkuptimeve gjatë komunikimit dhe ekzekutimit të urdhërave precizë. Ministria ka marrë të gjitha masat e nevojshme që incidente të tilla të mos përsëriten më. Duke ju komunikuar sa më lart, Ministria e Punëve të Jashtme shpreh keqardhjen më të thellë dhe përfiton nga ky rast për t'i rinovuar Legatës të Republikës Federative Popullore Jugosllave sigurimet e konsideratës së saj të lartë. Tiranë, 8 shkurt 1947".

vendeve, fondet e para të cilat do të ndihmonin në ndërtimin e hekurudhës Durrës-Elbasan dhe në fakt për ndërtimin e saj do të përdoreshin vetëm forca punëtore vullnetare nga Shqipëria.¹⁰⁴ Të qenët pranë një katastrofe financiare dhe e izoluar krejtësisht në marrëdhëniet e saj me Perëndimin, e vetmja dritare ku Tirana zyrtare mund të shikonte, ishte ajo jugosllave. Sipas raporteve të përpiluara nga Banka e Shtetit Shqiptar, shpërndarja e mallrave që vinin nga Jugosllavia ishte prioritet pasi marrëveshja ekonomike e nënshkruar ndërmjet dy vendeve një vit më parë e detyronte Shqipërinë t'iu qëndronte strikt pagesave dhe shlyerjeve financiare në dobi të Jugosllavisë.¹⁰⁵ Për gjithë vitin 1947 janë të shumta dokumentet që kam hulumtuar dhe që vërtetojnë pagesa prej miliona dinarësh të kryera nga Banka e Shtetit Shqiptar ndërmarrjeve të ndryshme në Jugosllavi për mallrat e lëvruar.¹⁰⁶ Vetë Banka Kombëtare e Jugosllavisë, sipas një shkrese të datës 19 qershor 1947, i impononte Shqipërisë se si do të menaxhohej kredia e akorduar prej 2 miliardë dinarësh nga ana saj dhe sa prej tyre do të lëvroheshin fillimisht në Shqipëri.¹⁰⁷ Sipas vetë raporteve që na vijnë nga Banka e Shtetit Shqiptar, kjo kredi e madhe për kohën e dhënë nga Jugosllavia mund të përballohej mirë nga financat shqiptare pasi ishte ende në fuqi franga shqiptare e cila, edhe pse përdorej në një vend me ekonomi të dobët, ishte përsëri një monedhë e qëndrueshme.¹⁰⁸ Në fakt, lëvrimi i kredisë prej 2 miliardë dinarësh akorduar Shqipërisë që në vitin 1946, duhej të lëvrohej brenda vitit 1947, por nga dokumentet e hulumtuara rezulton se deri në fund të shtatorit 1947 ishin lëvruar vetëm 520 000 000 dinarë nga 790 000 000 nga plani i parashikuar.¹⁰⁹ Megjithatë, deri në fund të vitit 1947 (31 dhjetor), Jugosllavia dërgoi gjithsej sipas dokumenteve shqiptare 1

¹⁰⁴ *Po aty*, V. 1947, D. 121, fl. 21. Çështje të ndryshme ekonomike midis dy vendeve (misri, materiale të hekurudhës etj.).

¹⁰⁵ *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1947, D. 8, fl. 1. Mbi shpërndarjen dhe pagesat ndaj mallrave që vinin nga Jugosllavia, Tiranë, 13 maj 1947.

¹⁰⁶ *Po aty*, fl. 5. "Pagesë 2 milion dinarë ndërmarrjes "Hidro Granja" në Beograd për llogari të shoqërisë shqiptaro-jugosllave të elektrikut".

¹⁰⁷ *Po aty*, fl. 10. "Në përputhje me marrëveshjet e fundit të nënshkruara në Beograd, kjo kredi do të përdoret për dërgimin në Shqipëri të mallrave të ndryshëm me vlerë 1.720.000.000 dinarë dhe shuma e mbetur prej 280.000.000 dinarësh do të përdoret për të blerë të tjera mallra në Jugosllavi".

¹⁰⁸ *Po aty*, fl. 12. Kursi i këmbimit: 1 frangë shqiptare = 9 dinarë jugosllavë.

¹⁰⁹ *AMPJ*, V. 1947, D. 123, fl. 1. Relacion mbi realizimin e kredisë prej 2 milionë dinarë.

356 811 698,49 dinarë.¹¹⁰ Gjithashtu, për të treguar se Shqipëria ishte totalisht e varur nga Jugosllavia, në fillim të vitit 1947 (16 janar) Kryeministri Hoxha urdhëroi zëvendës drejtorin e Bankës së Shtetit Shqiptar që të fillonte pa humbur kohë punën për shtypjen e monedhës së re shqiptare në marrëveshje me autoritetet kompetente jugosllave.¹¹¹ Edhe politikat e gabuara ekonomike të qeverisë shqiptare kishin bërë që jo pak shqiptarë të cilët posedonin napolona ari t'i shisnin pranë degëve të bankës në rrethe për të mbajtur shpirtin gjallë. Në këtë vit [1947], një monedhë [napolon] ari ishte e barabartë me 45 franga.¹¹²

Ajo që i interesonte më shumë Shqipërisë në këto momente ishte pa dyshim lëvrimi sa më shpejt i 2 miliardë dinarëve kredi që ishte firmosur që në korrik të vitit 1946. Nako Spiru i pranishëm në këtë mbledhje theksoi se kjo shumë ishte totalisht e pamjaftueshme për të ngritur ekonominë shqiptare dhe mbi të gjitha duheshin saktësuar ratat e pagesave në bisedimet me jugosllavët.¹¹³ Jugosllavia i kërkonte Shqipërisë në lidhje me akordin tregtar të nënshkruar për lëvrim mallrash në masën 600 milionë dinarë, gjë që për momentin ishte e pamundur për Shqipërinë.¹¹⁴ Shqipëria kishte nevojë urgjente që mallrat që do të vinin nga Jugosllavia sipas kredisë së nënshkruar, do të ndaheshin në mallra konsumi dhe materiale të destinuar për investime.¹¹⁵ Të gjitha mallrat që Shqipëria do të blinte nga Jugosllavia do të paguheshin në dinarë sipas marrëveshjes së nënshkruar në Beograd më 22 qershor 1947 ndërmjet Bankës Kombëtare të Jugosllavisë dhe Bankës së Shtetit Shqiptar.¹¹⁶ Ky element kishte një avantazh të madh për Jugosllavinë pasi Shqipëria i kishte bërë një dhuratë shumë të çmuar, kishte hequr nga qarkullimi

¹¹⁰ *Po aty*, fl. 3.

¹¹¹ *Po aty*, V. 1947, D. 140, fl. 1. Dokumente në lidhje me përfundimin e marrëveshjes mbi shtypjen e monedhës së re shqiptare.

¹¹² *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1947, D. 11, fl. 1. Blerje monedhash ari nga Banka shtetasve shqiptarë.

¹¹³ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1947, D. 17, fl. 2. Mbledhje e Byrosë politike më 29 maj 1947, mbi kërkesën jugosllave sipas dy telegrameve të dërguara nga N.D./Shef i Shtatmadhorisë të armatës jugosllave për të sjellë dy skuadrilje aeroplanësh dhe për të instaluar dy grupe baterish antiajrore.

¹¹⁴ *Po aty*, fl. 3.

¹¹⁵ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1947, D. 12, fl. 1. Mbi kategorizimin e mallrave që priteshin të vinin nga Jugosllavia, si pasojë e marrëveshjes së nënshkruar.

¹¹⁶ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1947, D. 13, fl. 1. Marrëveshje për pagesat e mallrave ndërmjet Bankës Kombëtare të Jugosllavisë dhe Bankës së Shtetit Shqiptar.

frangën dhe e kishte zëvendësuar me monedhën e re lek, e cila si pasojë e marrëveshjes së nëntorit të vitit 1946 do të ishte e barabartë me dinarin.¹¹⁷ Ndryshimi i monedhës shqiptare nga frangë në lek kishte sjellë edhe zhvlerësimin e kësaj të fundit krahasuar me monedhat e tjera ndërkombëtare sipas vetë Bankës së Shtetit Shqiptar.¹¹⁸ Ndryshimi i kartmonedhës shqiptare dëmtonte gjithashtu në masën 50% depozitat shqiptare të ish-Bankës Kombëtare të Shqipnis në Zyrih të Zvicrës, sipas njoftimeve që i kishte dërguar Nako Spiru ministrit të Financave Ramadan Çitaku gjatë vizitës së tij në Zvicër nëpërmjet Beogradit.¹¹⁹

Vetë Banka e Shtetit Shqiptar informonte se monedha e re lek, e cila do të hynte në veprim më datë 11 korrik 1947 [nga data 11 deri 20 korrik do të kryhej zëvendësimi i plotë i monedhës së vjetër me monedhën e re], do të ishte më e dobët se franga shqiptare dhe kjo vërtetohet nga vetë kursi i këmbimit të tyre: 1 frangë shqiptare=9 lekë.¹²⁰ E kam shumë të vështirë të vërtetoj nëse ky dëm ndaj vendit erdhi si pasojë e injorancës në drejtimin e punëve të shtetit nga ana e lidërshipt komunist shqiptar, apo ishin të detyruar ta bënin një gjë të tillë. Ndryshimi i monedhës sipas vetë raporteve të bankës, ishte shoqëruar në qytete të ndryshme edhe me rritje çmimesh nga 5 deri 10%, sidomos në sektorin privat për aq sa kishte mbetur.¹²¹ Pushteti komunist e justifikoi ndryshimin e monedhës për të barazuar monedhën e re [lekun] me dinarin jugosllav, e cila sipas tyre ishte monedha më e garantuar në Ballkan.¹²²

¹¹⁷ *Po aty*, fl. 2. "1 dinar=1 lek"; shih edhe fl. 4. "Dinarët dhe lekët efektivë, t'importuem në Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë e respektivisht në Republikën Popullore të Shqipnisë, sipas paragrafit të sipërm, nuk mund të shkëmbehen vetëm se me monedhën e vendit, d.m.th., në Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë pranë Bankës Kombëtare të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, në degët e saj e në vende të tjera të autorizuese prej saj, dhe në Republikën Popullore të Shqipnisë pranë Bankës së Shtetit Shqiptar, pranë degëve të saj dhe në vende të tjera të autorizuese prej saj".

¹¹⁸ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1947, D. 14, fl. 2. Konvertim monedhash argjendi ndërmjet lekut dhe shteteve të ndryshme.

¹¹⁹ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1947, D. 15, fl. 2-4. Mbi pamundësinë e konvertimit të lekut me monedhat e tjera për vitin 1947.

¹²⁰ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1947, D. 24, fl. 1. Mbi emetimin e monedhës së re në Republikën Popullore të Shqipërisë, 7 korrik 1947.

¹²¹ *Po aty*, fl. 27.

¹²² *Po aty*, fl. 52. "Nga botimet në gazetën Bashkimi, nga konferencat e zhvillueme me këtë rast, populli e kishte kuptue mjaft mirë se randësia e zhdukjes së frangut dhe krijimit të lekut në këtë mes ishte ba për t'u barazue me dinarin, monedhën ma të

Ndryshimi i monedhës solli gjithashtu edhe humbje të mëdha në valutë të huaj, aq shumë e domosdoshme për ekonominë shqiptare.¹²³ Ndryshimi i monedhës nga ana e Shqipërisë ishte favori më i madh që iu bë Jugosllavisë nga qeveria komuniste shqiptare.

...vijon në numrin e ardhshëm /...to be continued

Bibliografi:

Burime arkivore:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

F. 490/Këshilli i Ministrave [KM]: 1945, 1946

F. 506/Banka e Shtetit Shqiptar [BSHSH]: 1945, 1946, 1947

F. 14/Organet Udhëheqëse [OU]: 1946, 1947

F. 14/Strukturë [Str]: 1946

Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme i Republikës së Shqipërisë, Fondi MPJ (AMPJ)
Vitet 1946, 1947.

Literaturë historiografike:

Armour, Ian D. *A history of Eastern Europe 1918 to the present; Modernisation, Ideology and Nationality*. London: Bloomsbury Academic, 2021.

Berman, Sheri. *Democracy and Dictatorship in Europe; From the Ancient Régime to the present day*. New York: Oxford University Press, 2019.

Jeffries, Ian. *Socialist economies and the transition to the Market; a guide*. London and New York: Routledge, 1993.

Jelavich, Barbara. *History of the Balkans; Twentieth Century*, vol. 2. New York: Cambridge University Press, 1983.

Kaba, Hamit. *UNRRA në Shqipëri, 1944-1947*. Tiranë: Shkenca, 2000.

Krisafi, Ksenofon. *Në kërkim të arit; historia e arit shqiptar të rrëmbyer gjatë Luftës së Dytë Botërore*. Tiranë: Dita 2000 & UET Press, 2008.

Unkovski-Korica, Vladimir. *The economic struggle for power in Tito's Yugoslavia; from World War II to Non-Alignment*. London: I.B. Tauris, 2016.

garantueme në Ballkan, dhe këtë në bazë të konventës të lidhur me Aleaten tonë të madhe Jugosllavinë e Marshallit Tito".

¹²³ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1947, D. 25, fl. 4. Humbje nga vlerësimi i llogarive debitore në valutë të huaj si pasojë e ndryshimit të monedhës.

GJON BORIÇI

Institute of History/ Academy of Sciences of Albania
gjon.borici@asa.edu.al

S u m m a r y

A VIEW IN POLITICAL - ECONOMIC TERMS BETWEEN ALBANIA AND
YUGOSLAVIA IN THE PERIOD 1945-1949
(Part one, January 1945 - June 1947)

It's a real challenge to write about Albanian-Yugoslav relations in the second half of the '40ies of the XX century. In this first part of this paper, I have tried to focus on the reasons why Albania chose Yugoslavia as the closest political and economic partner in the postwar period. Both countries were exercising the same structures of power and embraced the same political regime. Both communist countries took the power immediately after the respective liberation of their territories from the nazi occupation. Albania in these two and a half years, exercised a disastrous political and consequently policies which led to complete bankruptcy and total dependence on Yugoslav credits and loans. From the other side, the Yugoslav were much more flexible in their policies by trying to be as much as they could independent from Moscow's tutelage and having more or less a solid place in the future international relations. Due to Albania's disastrous economic policies, Yugoslavia succeeded to completely subdue the tiny neighbor country, in the beginning in economic terms. The most significant economic victory of Yugoslavia towards Albania was the currency parity when was clearly visible according the Albanian experts of the State Bank of Albania that Albanian currency the franc was much more stronger than the Yugoslav dinar. In these two and a half years of close relationship, Yugoslavia did what she wanted with Albania and through the credit of 2 billion dinars, paved the way to the complete political mastering of Albania in every sector.

